

20131192834

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në përputhje me nenin 75 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë dhe Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nxjerrin

NJË DEKRET PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN PËR ARMËT

Shpallet ligji “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët”,
i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e zhvilluar në datën 26 gusht 2013

Numër 07-3229/1
26 gusht 2013
Shkup

President
i Republikës së Maqedonisë,
Gjorgje Ivanov, nënshkrimi

Kryetar
i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë
Trajko Veljanoski, nënshkrimi

LIGJ PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN PËR ARMËT

Neni 1

Në ligjin “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008, 72/10 dhe 158/11), neni 3 paragrafi 2 ndryshohet si më poshtë:

“Armë zjarri” është çdo armë e transportueshme me tytë (pushkë, pistoletë dhe revolver) që realizon apo është projektuar për të realizuar ose mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtëna, plumba ose predha, nën trysninë e lëndëve djegëse. Për qëllime të këtij ligji, një armë zjarri është çdo objekt që mund të modifikohet për të realizuar të shtëna, plumba ose predha nëse paraqitja e objektit përputhet me armën e zjarrit dhe nëse mënyra e saj e ndërtimit apo materialet mund të modifikohen”;

Pas paragrafit 2 shtohen paragrafët 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“Nuk konsiderohen si armë zjarri pjesët e armëve të zjarrit ose objektet të cilat janë projektuar që nën trysninë e lëndëve djegëse të realizojnë të shtëna, plumba ose predha, si dhe pjesët që mund të modifikohen për të realizuar të shtëna, plumba ose predha, nëse:

- me procedura teknike janë paaftësuar përgjithmonë për përdorim,
- janë të prodhuara për alarmim, sinjalizim, shpëtim të jetës, vrasje të kafshëve, peshkim me harpun ose janë të prodhuara për qëllime industriale ose teknike dhe vetëm nëse përdoren për atë qëllim;
- janë pjesë të armëve antike ose imitime të armëve antike që nuk janë të përfshirë në kategorinë e armëve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji;

“Pjesë e armës së zjarrit” është çdo pjesë kryesore, rezervë dhe pjesë tjetër e armës së zjarrit e nevojshme për funksionimin e saj (tyta me folenë e fishekëve, kutia e tytës, mekanizmi i këmbëzës së shkrepjes, gjilpëra goditëse, shuli me shtratin e shulit), si dhe çdo pajisje e projektuar ose e përshtatur për të zvogëluar zhurmën e shkaktuar nga e shtëna me armë zjarri;”.

Paragrafi 25 numërtohet “27” dhe ndryshohet si më poshtë:

“Pjesët kryesore të armës së zjarrit” janë tyta me folenë e fishekut, mekanizmi i këmbëzës së shkrepijes dhe kutia, të cilat prodhohen për t’u montuar ose montohen tek arma e zjarrit dhe përfshihen në kategorizimin e armëve të përcaktuara me nenin 4 të këtij ligji;

Paragrafi 27 numërtohet “29” dhe pas fjalës “shoqëri” shtohen fjalët: “pa autorizim për të blerë armë”.

Paragrafi 32 numërtohet “34” dhe ndryshohet si më poshtë:

“Municion” është i gjithë fisheku ose pjesët e tij (të gjithë llojet e fishekëve, kapsollat, baruti, plumbi dhe predhat) të cilët nëpërmjet lëndës së ndezshme shërbejnë për mbushjen dhe funksionimin e armës së zjarrit;

Paragrafi 40 numërtohet “42” dhe në fund të fjalisë lidhësja “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Paragrafi 41 numërtohet “43” dhe pika në fund zëvendësohet me pikëpresje dhe pas saj shtohen paragrafët 44, 45, 46, 47 me këtë përmbajtje:

“Gjurmimi i armëve” nënkupton gjurmimin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre nga prodhuesi te blerësi me qëllim ndjekjen, zbulimin dhe analizimin e prodhimit dhe tregtimit të paligjshëm të armëve të zjarrit;

“Ndërmjetësues (broker) armësh” është një person fizik - pronar i vetëm ose subjekt juridik veprimtaria e të cilit përbëhet nga ndërmjetësimi pjesor ose tërësor, marrëveshjet e prokurimit, shitja ose transportimi i armëve, që ndryshon nga veprimtaria e shoqërive të përmendura në nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji;

“Tregtar armësh” është një person fizik – pronar i vetëm ose subjekt juridik i cili kryen pjesërisht ose tërësisht veprimtarinë e prodhimit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre apo veprimtari të tjera të lidhura me prodhimin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, si dhe veprimtarinë e shitjes, riparimit, shkëmbimit ose dhënies me qira të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, d.m.th. shoqëritë e përmendura në nenin 35-a paragrafi 3, nenin 46 paragrafi 1, nenin 52 paragrafi 1 dhe nenin 59 paragrafi 3 të këtij ligji; dhe

“Leja evropiane për armët e zjarrit” është dokument që vërteton pronësinë dhe të drejtën e përdorimit të armës së zjarrit nga ana e zotëruesit të lejes, e cila nuk mund të transferohet te persona të tjerë dhe mbahet nga personi gjatë gjithë kohës së përdorimit të armës.”

Neni 2

Në nenin 4 paragrafi 2 pika 11 lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 12, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje dhe pas saj shtohen pikat 13, 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“13) armë zjarri e e përbërë nga pjesët kryesore të armës së zjarrit që janë bëlerë nga tregtia e paligjshme,

14) një armë e prodhuar së fundmi që nuk është markuar në përputhje me rregulloret për testimin dhe vulosjen (d.m.th. markimin, dhe

15) një armë e modifikuar, d.m.th. e ndryshuar”.

Në paragrafin 5 pika 5 lidhësja “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 6, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje dhe pas saj shtohen pikat 7,8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“7) armët pneumatike me energji kinetike nga 10,5 J ose më shumë, ose me shpejtësi të predhës 200 m/s ose më të madhe dhe me kalibër më të madh se 4,5 mm;

8) armët për sinjalizim akustik dhe me dritë dhe

9) armët me hark me forcë të tensionit të harkut mbi 45 kilogramë dhe”.

Në paragrafin 6 pika 1 pas fjalës “armë” shtohen fjalët: “me energji kinetike më të vogël se 10,5 J ose me shpejtësi të predhës më të vogël se 200 m/s dhe kalibër 4,5 mm”.

Pika 2 ndryshohet si në vijim:

”2) armë me hark me forcë të tensionit të harkut deri në 45 kilogramë dhe”.

Në pikën 3 lidhësja “dhe” zëvendësohet me pikë.

Pika 4 fshihet.

Neni 3

Në nenin 5 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2, me këtë përmbajtje:

“Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet për çdo blerje individuale të armës”.

Neni 4

Në nenin 7 paragrafi 8 dhe në nenin 8 paragrafi 3 fjalët: “janë të regjistruara për mbrojtjen e personave dhe të pronës ose kryejnë funksionin e mbrojtjes së personave dhe të pronës për nevoja personale” ndryshohen me fjalët: “kryejnë shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë private ose sigurim privat për nevoja personale”.

Neni 5

Në nenin 9, paragrafi 1 pika 7 riformulohet si më poshtë:

”7) me vendbanim të përhershëm në territorin e Republikës së Maqedonisë me kartë identiteti të vlefshme, ndërsa personat e huaj duhet të kenë leje qëndrimi të miratuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kartë identiteti për të huaj të vlefshme, me përjashtim të rasteve kur rregullohet ndryshe nga një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar.“

Në paragrafin 2 fjalët: “kategoria C” zëvendësohet me fjalët: “neni 4 paragrafi 5 pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

“Leja për blerjen e armëve të përmendura me nenin 4 paragrafi 5 pikat 7, 8 dhe 9 të këtij ligji lëshohet për personat fizikë që plotësojnë kërkesat e përmendura në paragrafin 1 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 7 të këtij neni”.

Neni 6

Në nenin 14 pas paragrafit 10 shtohet neni 11 me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e komisionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni kanë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve për zhvillimin e provimit, të cilat mbulohen nga subjekti ligjor i autorizuar i përcaktuar me paragrafin 5 të këtij neni.”

Paragrafi 11 numërohet “12” dhe fjala “policia” zëvendësohet me fjalët: “punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, strukturat speciale operacionale të policisë, që kanë shërbyer në polici për të paktën tre vjet, punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të dalë në pension”.

Paragrafi 12 bëhet paragrafi 13.

Neni 7

Në nenin 15 paragrafi 4 ndryshohet si më poshtë:

“Personat që kanë licencë për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë private e përdorin atë për të vërtetuar se janë në përputhje me kërkesën e përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 pika 6 të këtij ligji.”

Pas paragrafit 4 shtohet paragrafi 5 me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e strukturave speciale operacionale të policisë që kanë shërbyer në polici të paktën tre vjet, si dhe punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme që kanë dalë në pension, e vërtetojnë përmbushjen e kërkesës së përmendur në nenin 9 paragrafi 1 pika 6 të këtij ligji me anë të një vërtetimi të lëshuar nga autoriteti shtetëror në të cilin kanë kryer

detyrat dhe funksionet e kërkuara.”

Neni 8

Në nenin 16 paragrafi 1 pika 1 fjalët: “për sigurim të personave dhe pronës” fshihen.

Në paragrafin 2 fjalët: “mbrojtja e personave dhe pronës ose kryejnë funksionin e sigurisë së personave dhe pronës” ndryshohen me fjalët: “sigurim privat”

Neni 9

Në nenin 18 paragrafi 2 pas fjalëve: “të dhëna për armën” shtohen fjalët: “(lloji, marka, kalibri dhe numri i fabrikimit të armës)”.

Neni 10

Në nenin 18-a shtohen paragrafët 1, 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

“Qitjet eksperimentale me armë realizohen me armët e përcaktuara me nenin 4 paragrafi 4 dhe nenin 4 paragrafi 5 pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.

Qitjet eksperimentale me armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni realizohen me dy copë municionesh të përshtatshme për llojin e armës, që sigurohen pa leje, dëshmi, d.m.th. autorizimi i përmendur në nenin 7 paragrafi 3 dhe 4 të këtij ligji.

Shoqëritë e përmendura në nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji dhe personi fizik që shet armë në përputhje me nenin 35 të këtij ligji kanë për detyrë t’i shesin blerësit të armës të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni tre copë municionesh të përshtatshme për llojin e armës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nëse arma nuk është testuar më parë.”

Paragrafi 1 dhe 2 numërtohen përkatësisht paragrafi 4 dhe 5.

Neni 11

Në nenin 19 pas paragrafit 1 shtohet neni i ri 2 me këtë përmbajtje:

“Për lëshimin e lejes për një shtetas të huaj organi përgjegjës e njofton shtetin e tij brenda 15 ditëve.”

Paragrafi 2 numërtohet paragrafi 3.

Neni 12

Në nenin 23 paragrafi 1 fjalët: “sigurimi i personave dhe pronës” ndryshohen me fjalët: “sigurim privat”

Neni 13

Në nenin 24 fjalët: “sigurimi i personave dhe pronës” ndryshohen me fjalët:

“sigurim privat”

Neni 14

Në nenin 31 paragrafi 15 ndryshohet si në vijim:

“Armët sportive, armët pneumatike, armët për sinjalizim akustik dhe armët me hark mund të përdoren nga persona minorene vetëm në poligon qitjeje, vend gjuetie ose ambient tjetër të siguruar për trajnim, dhe vetëm në praninë dhe mbikëqyrjen e prindërve ose të një personi tjetër në moshë madhore që është i pajisur me leje të vlefshme për armë.”

Neni 15

Në nenin 35 paragrafi 2 pas fjalës “markë” vendoset presje dhe shtohen fjalët: “numër fabrikimi”.

Në paragrafin 3 fjalët: “paragrafi 2” ndryshohen me fjalët: “paragrafi 2 dhe 5”, ndërsa pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “nëse nga arma nuk është

kryer qitje eksperimentale.”

Pas paragrafit 3 shtohen paragrafët e rinj 4, 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“Nëse nga arma që është blerë në përputhje me paragrafin 2 dhe 5 të këtij neni janë kryer qitje eksperimentale, personat fizikë, d.m.th. subjektet juridike që kanë blerë armën janë të detyruar që brenda tetë ditëve të paraqesin kërkesën për regjistrimin e armës dhe të dërgojnë kontratën e përmendur me paragrafin 2 të këtij neni tek organi përgjegjës.

Në përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni arma e zjarrit, pjesët dhe municionet e armës mund të blihen nëpërmjet lidhjes së një kontrate në distancë, në përputhje me ligjin.

Para blerjes së armës së përcaktuar me paragrafin 5 të këtij neni personi fizik ose juridik i paraqet shitësit të armës kopje të lejes së përmendur në paragrafin 9 dhe 16 të këtij ligji.

Gjatë blerjes së armës të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni kryhet kontroll i veçantë për prokurimin e armëve nga ana e organit përgjegjës, përveç rastit kur shitja kryhet ndërmjet tregtarëve të armëve.

“Kontrolli i veçantë i armës”, në kuptimin e paragrafit 7 të këtij neni, konsiderohet kontrolli që kryen organi përgjegjës në lidhje me përmbushjen e kërkesave për tregtimin dhe transportimin e armëve të parashikuara me këtë ligj dhe ligje të tjera.”

Neni 16

Pas nenit 35 shtohet neni 35-a me këtë përmbajtje:

“Neni 35-a

Armët e të njëjtit lloj mund të jenë subjekt shkëmbimi ndërmjet personave fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund t’i shkëmbejnë armët e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni nëse ata disponojnë autorizim për armë, ose lejen e përcaktuar me nenin 27 paragrafi 2 të këtij ligji.

Subjektet mund ti shkëmbejnë armët e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni nëse ata kanë autorizim për armë apo dëshmi e përmendur në nenin 27 paragrafi 2 të këtij ligji.

Dispozitat e përcaktuara me nenin 35 paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji zbatohen për shkëmbimet e armëve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.”

Neni 17

Pas nenit 38 shtohet neni 38-a me këtë përmbajtje:

“Neni 38-a

Pronari i armëve të cilat i përkasin kategorive B, C dhe D për të cilat lëshohet autorizim për armët, autorizim për mbajtjen e armës, apo dëshmia e përcaktuar me nenin 27 paragrafi 2 të këtij ligji mund ta dorëzojë vullnetarisht armën në stacionin më të afërt të policisë.

Stacioni i policisë i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni brenda 15 ditëve e njofton organin përgjegjës për personin dhe armën që është dorëzuar vullnetarisht.

Për armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet një mandat.

Autorizimet për armët, d.m.th. lejet për të poseduar armë trajtohen nga autoriteti kompetent në përputhje me nenin 42 të këtij ligji”.

Neni 18

Në nenin 42 paragrafi 1 pas fjalëve: “mbajtja e një arme” shtohen fjalët: “dhe dëshmia e përmendur në nenin 27 paragrafi 2 të këtij ligji”.

Në pikën 3 lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje:

“4) kur arma është dorëzuar vullnetarisht nga pronari i saj në përputhje me nenin 38-a të

këtij ligji dhe”.

Pika 4 numërohet “5”.

Në paragrafin 2 pas fjalës “armë” shtohen fjalët: “dhe dëshmia e përmendur në nenin 27 paragrafi 2 të këtij ligji”.

Në pikën 1 pas fjalës “autorizim” shtohen fjalët: “dhe leja”, ndërsa lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 1 shtohet pika 2 me përmbajtje:

“2) kur arma dorëzohet vullnetarisht nga pronari i saj në përputhje me nenin 38-a të këtij ligji dhe”.

Pika 2 numërohet “3”.

Në paragrafin 6 fjalët: “pika 4” ndryshohet me fjalët: “pika 5”, ndërsa fjalët: “pika 2” ndryshohen me fjalët: “pika 3”.

Në paragrafin 7 fjalët: “numri 3” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi 1 pika 4, paragrafi 2 pika 2 dhe paragrafi 3”.

Neni 19

Në nenin 46 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

“Prodhimi i paligjshëm i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohet çdo prodhim ose magazinim i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre:

- nga pjesët kryesore të armës së zjarrit që prokurohen në mënyrë paligjshme,
- të cilat nuk janë markuar gjatë kohës së prodhimit ose magazinimit, në përputhje me rregulloren për vulosjen, testimin dhe markimin e armëve, dhe
- ato të cilat nuk janë kontrolluar, vulosur dhe markuar në përputhje me rregulloren për vulosjen, kontrollimin dhe markimin e armëve”, si dhe për të cilat nuk është lëshuar dëshmia e përcaktuar me nenin 51-a paragrafi 4 të këtij ligji, ndërkohë që ato janë hedhur në qarkullim.”

Paragrafi 3 dhe 4 numërohen përkatësisht 4 dhe 5.

Neni 20

Pas nenit 48 shtohet neni 48-a me këtë përmbajtje:

“Neni 48-a

Për ndjekjen e plotë të procesit të prodhimit, riparimit, tregtimit dhe transportimit të armëve organi përgjegjës mban një regjistër elektronik të armës.

Shoqëritë e përmendura në nenin 46 paragrafi 1 dhe nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të jenë të lidhura në mënyrë elektronike me regjistrin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe të hedhin të dhënat dhe të dorëzojnë dokumentet për armën.

Shoqëritë e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni kanë për detyrë të regjistrojnë në regjistrin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të dhënat për:

- shoqërinë (emri, selia, NIPT-i dhe drejtuesi),
- armën (kategoria, marka, modeli, kalibri, numri i fabrikimit, prodhuesi i armës, vendi nga ku është eksportuar arma, eksportuesi dhe data e importimit në Republikën e Maqedonisë),
- blerësin e armës (personi fizik ose juridik dhe adresa e banimit ose selia),
- tregtarin e armës (person fizik ose juridik)
- autorizimin për blerjen e armës (numër dhe datë), dhe
- kontratën e shitblerjes në rastin kur arma blihet nga një person fizik (numri dhe data e lidhjes së kontratës).

Përpos detyrimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, shoqëritë kanë për detyrë të mbajnë regjistra edhe për ndjekjen e procesit të prodhimit, riparimit, tregtimit dhe

transportimit të armës.

Në regjistrat e përmendur ne paragrafin 4 të këtij neni, shoqëritë kanë për detyrë të regjistrojnë të dhënat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.

Të dhënat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni dhe regjistri i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni përpunohen për arsye të realizimit të qëllimeve të parashikuara në këtë nen dhe ruhen për të paktën 20 vjet.

Pas përfundimit të veprimtarisë së saj, shoqëria brenda tetë ditëve e dorëzon regjistrin e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni tek organi përgjegjës.

Ministri i Punëve të Brendshme përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit elektronik të armës, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për ndjekjen e procesit të prodhimit, riparimit, tregtimit dhe transportimit të armëve.”

Neni 21

Në nenin 49 paragrafi 3, 4 dhe 5 ndryshohen si në vijim:

“Pas riparimit të pjesëve kryesore të armëve të zjarrit, personi fizik ose juridik ka për detyrë që brenda tetë ditëve nga data e marrjes së armës së riparuar, ta regjistrojë armën për qitje eksperimentale dhe të paraqesë kërkesën për regjistrimin e pjesëve kryesore të riparuar të armës së zjarrit.

Shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë që brenda pesë ditëve nga përfundimi i riparimit të pjesëve kryesore të armës së zjarrit të dërgojnë njoftim për përfundimin e riparimit tek organi përgjegjës.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni përmban të dhënat e personit fizik ose juridik që ka në pronësi armën që i është kryer riparimi i pjesëve kryesore si dhe të dhënat për armën.”

Neni 22

Në nenin 52 paragrafi 4 ndryshohet si më poshtë:

“Në kuptimin e këtij ligji, tregti e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre është prokurimi, shitja, furnizimi, ndërmjetësimi, transportimi ose transferimi i armëve të zjarrit, pjesëve dhe municioneve të tyre.”

Pas paragrafit 4 shtohet paragrafi 5 me përmbajtje:

“Në kuptimin e këtij ligji, trafikim i paligjshëm i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, konsiderohet çdo prokurim, shitje, furnizim, ndërmjetësim, transportim ose transferim i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë, nga ose përmes territorit të Republikës së Maqedonisë, nëse transportimi i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre nuk është i lejuar nga të gjitha shtetet përmes të cilave kalojnë, si edhe prokurimi, shitja, furnizimi, transportimi apo transferimi i armëve të zjarrit që nuk janë të markuara në përputhje me rregulloren për kontrollin, vulosjen dhe markimin, si dhe nuk është lëshuar dëshmia e përmendur në nenin 51-a paragrafi 4 i këtij ligji.”

Paragrafët 5, 6, 7 dhe 8 numërtohen përkatësisht 6, 7, 8 dhe 9.

Neni 23

Në nenin 53 pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: “armë për të cilat është lëshuar dëshmia e përmendur në nenin 51-a paragrafi 4 i këtij ligji.”

Neni 24

Pas nenit 54 shtohet neni 54-a me këtë përmbajtje:

“Neni 54-a

Ndërmjetësuesi i armëve kryen ndërmjetësimin e armëve, nëse:

- veprimtaria është e shënuar në regjistrin tregtar dhe
- i është lëshuar autorizim nga organi përgjegjës për kryerjen e ndërmjetësimit të armëve.

Autorizimi për kryerjen e ndërmjetësimit të armëve lëshohet nëse ndërmjetësuesi i armëve plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 47 paragrafi 2 pika 1 i këtij ligji.”

Neni 25

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Në kuptimin e këtij ligji, transferim i armëve, municioneve dhe pjesëve të armëve është çdo veprimtari e ndërmarrë gjatë importit, eksportit dhe transitit për sasitë e rënda dakord më parë të armëve, municioneve dhe pjesëve të armëve ndërmjet shoqërive të përmendura në nenin 46 paragrafi 1 dhe nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji dhe shoqërive tregtare të huaja.

Transferimi i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, përmes pikës kufitare shtetërore kryhet nga ana e shoqërive tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat pajisen me autorizim nga organi përgjegjës, pas sigurimit të një vlerësimi paraprak nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes.

Kërkesa për lëshimin e autorizimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni përmban:

- emrin dhe selinë e furnitorit, marrësit dhe transportuesit,
- emrin dhe selinë e prodhuesit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre,
- të dhënat për markimin dhe stampimin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre në përputhje me ligjin (lloji, marka dhe kalibri) dhe
- sasinë e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre.

Paraqitësi i kërkesës së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni është i detyruar që bashkëngjitur kërkesës të dërgojë dhe:

- lejen e importit ose transitit nga shteti ku armët, pjesët dhe municionet e tyre eksporthen dhe shtetet që do të kalojnë transit,
- dëshminë (certifikatën) e përdoruesit final të lëshuar nga organi përgjegjës; dhe
- kontratën ose dokument tjetër që vërteton sasinë e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre për të cilat është rënë dakord.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni nuk është më i vlefshëm nëse ndërmerren masa kufizuese në përputhje me rregulloret mbi masat ndërkombëtare kufizuese.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni dhe autorizimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dorëzohen ose lëshohen në format elektronik.”

Neni 26

Neni 56 ndryshohet si në vijim:

“Për transportimin e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre gjatë importit, eksportit dhe transitit përmes pikave kufitare është i nevojshëm autorizimi i lëshuar nga organi përgjegjës.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet për shoqëritë tregtare të përmendura në nenin 46 paragrafi 1 dhe nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji.

Shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni paraqesin një kërkesë për lëshimin e autorizimit për transportimin e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre përmes pikave kufitare, që përmban:

- emrin dhe selinë e furnitorit, marrësit dhe transportuesit,
- emrin dhe selinë e prodhuesit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre,
- të dhënat për markimin dhe vulosjen e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre në përputhje me ligjin (lloji, marka, kalibri dhe numri i fabrikimit),

- sasinë e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre,
- itinerarin e lëvizjes (pikat kufitare të hyrjes dhe daljes dhe destinacionin final),
- të dhënat e mjetit të transportit (vendi i origjinës, lloji, targa, certifikata ADR e mjetit nëse transportohen municione ose materiale të shpërthyeshme) dhe
- të dhënat e shoferit (emri, mbiemri, vendi i origjinës, adresa, mjet identifikimi dhe certifikata ADR e shoferit nëse transportohen municione ose materiale të shpërthyeshme).

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat e kërkesës së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

Organi përgjegjës, gjatë lëshimit të autorizimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, mundet që në bazë të nevojave të vendosë masa sigurie gjatë transportimit të armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre në përputhje me ligjin.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet për një afat shfrytëzimi deri në dy muaj.

Për transportin e kryer të armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre, shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni që marrin në dorëzim armët, pjesët dhe municionet e tyre, kanë për detyrë që brenda pesë ditëve të njoftojnë organin përgjegjës që ka lëshuar autorizimin.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 7 të këtij neni dorëzohet në formë elektronike ose në letër.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni dhe autorizimi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dërgohen ose lëshohen edhe në formë elektronike.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni i bashkëngjitet armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre deri në destinacionin final.

Armët, pjesët dhe municionet e tyre, që kalojnë transit përmes territorit të Republikës së Maqedonisë nuk markohen në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.”

Neni 27

Pas nenit 56 shtohet neni 56-a me këtë përmbajtje:

“Neni 56-a

Transportin e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë e kryejnë shoqëritë tregtare të përmendura në nenin 46 paragrafi 1 dhe nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji.

Shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dorëzojnë kërkesën për t’u pajisur me autorizim për transportin e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë, e cila përmban:

- emrin dhe selinë e furnitorit, marrësit dhe transportuesit,
- të dhënat për markimin e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre në përputhje me ligjin (lloji, marka, kalibri dhe numri i fabrikimit),
- sasinë e armëve, pjesëve dhe të municioneve të tyre,
- itinerarin e lëvizjes dhe destinacionin final,
- të dhënat për mjetin e transportit (lloji dhe targa) dhe
- të dhënat për shoferin (emri, mbiemri, adresa e banimit dhe dokumenti i identifikimit).

Organi përgjegjës që lëshon autorizimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të vendosë masa sigurie, në bazë të nevojës, gjatë kohës së transportimit.

Në autorizimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vendosen data e fillimit dhe përfundimit të transportimit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre drejt destinacionit final.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni i shoqëron armët, pjesët dhe municionet e tyre deri në destinacionin final.

Për transportin e realizuar të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre, shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë që brenda pesë ditëve të njoftojnë organin përgjegjës që ka lëshuar autorizimin dhe organin përgjegjës në vendin e destinacionit.

Njoftimi i përmendur në paragrafin 6 të këtij neni dorëzohet në formë elektronike ose në letër.”

Neni 28

Në nenin 59 paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

“Qitjet në poligonet civile të qitjes mund të kryhen nga çdo person fizik.”

Pas paragrafit 2 shtohen paragrafët 3, 4 dhe 5 që përmbajnë:

“Nëse personi fizik i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk ka armë të vetën për qitje, mund të marrë me qira armë dhe municione nga poligoni civil i qitjes në të cilin realizohet qitja.

Personi fizik i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të qëllojë në poligonin e qitjes civile në prani të përfaqësuesve të subjekteve juridike të përmendura në nenin 58 paragrafi 2 të këtij ligji.

Subjektet juridike e përmendura në nenin 58 paragrafi 2 të këtij ligji janë të detyruara të ndërmarrin masa për parandalimin dhe zgjidhjen e dëmeve të shkaktuara nga qitjet joprofesionale në poligonet civile të qitjes të parashikuara në ligje dhe aktet nënligjore.”

Neni 29

Në nenin 62 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me përmbajtje:

“Mbajtësi i armës për të cilin është lëshuar autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ka për detyrë të nxjerrë armën jashtë kufirit të Republikës së Maqedonisë në largimin e tij të parë nga territori i Republikës së Maqedonisë.”

Neni 30

Neni 64 ndryshohet si më poshtë:

“Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët qëndrojnë jashtë vendit dhe kanë qëllim të kthehen dhe të qëndrojnë përgjithmonë në Republikën e Maqedonisë, dhe shtetasit e huaj me qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë gjatë kalimit të kufirit shtetëror kanë për detyrë të deklarojnë në doganë armën me të cilën kanë ndërmend të hyjnë në Republikën e Maqedonisë dhe për të cilën disponojnë autorizim të vlefshëm për armën të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër.

Pas regjistrimit të armës nga shërbimi doganor, lëshohet autorizim për hyrjen e armës dhe municionin e saj, pas së cilit arma hyn në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni brenda tetë ditëve nga dita e lëshimit të autorizimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni duhet të paraqesin kërkesën për ndryshimin e autorizimit të armës të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër, si dhe të dorëzojnë armën për kryerjen e qitjeve eksperimentale.

Gjatë ndryshimit të autorizimit të armës, të lëshuar nga organi përgjegjës i një shteti tjetër, kryhet kontrolli i vlefshmërisë dhe i autenticitetit të saj.

Nëse kërkesa e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni refuzohet, personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet që brenda tetë ditëve ta nxjerrin armën jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë.

Dispozitat e paragrafëve 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni nuk zbatohen për armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, për të cilat është i ndaluar prokurimi dhe posedimi i tyre në Republikën e Maqedonisë dhe të njëjtat nuk duhet të hyjnë në territorin e Republikës së Maqedonisë.”

Neni 31

Neni 65 ndryshohet si në vijim:

“Shtetasi i huaj mund të blejë armë zjarri në Republikën e Maqedonisë në përputhje me kategorizimin e armëve të përmendur në nenin 4 të këtij ligji, në bazë të një dokumenti të posaçëm dhe të vlefshëm për armën, i cili lëshohet nga organi përgjegjës i shtetit të shtetasit të huaj.

Dokumenti i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë i përkthyer në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik dhe duhet të jetë vërtetuar autenticiteti i tij nga ana e përfaqësisë diplomatike të shtetit të shtetasit të huaj në Republikën e Maqedonisë.

Pas blerjes së armës të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, tregtari i armëve paraqet një kërkesë tek organi përgjegjës për transferimin e armës.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme:

- emrin, mbiemrin dhe adresën e shitësit, dhe nëse është e mundur edhe emrin, mbiemrin dhe adresën e pronarit të armës,
- emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të blerësit të armës,
- adresën ku do të dërgohet apo transportohet arma,
- numrin e copëve të armëve që do të dërgohen ose transportohen,
- identifikimin më të lehtë të armës, ose të dhënat për kontrollin dhe vulosjen, pra markimin e armës në përputhje me ligjin,
- mënyrën e transportimit të armës,
- datën e fillimit të transportimit të armës; dhe
- afatin për eksportimin e armës.

Bashkëngjitur kërkesës dorëzohen edhe këto dokumente:

- dokumenti i identifikimit i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe
- vërtetimi për shitblerjen e armës.

Pas kërkesës së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni organi përgjegjës lëshon autorizimin për transportimin e armëve.

Autorizimi për transportimin e armëve përmban të dhënat e kërkesës së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

Pas miratimit të autorizimit për transportimin e armëve, tregtari i armës i dorëzon armët për transport ose i dërgon me postë te shtetasi i huaj.

Autorizimi për transportimin e armëve i ndjek armët gjatë kohës së transportimit të tyre ose dërgimin e tyre në destinacionin final në shtetin e shtetasit të huaj.

Autorizimi për transportimin e armëve tregohet me kërkesë të organeve përgjegjëse në territorin e të cilave transportohen ose dërgohen armët.

Për autorizimin e transportimit të armëve njoftohet shteti i destinacionit final të armës dhe shtetet në territorin e të cilëve do të kalojnë transit armët.

Shtetasi i huaj që kalon përmes territorit të Republikës së Maqedonisë mund ta kalojë armën që mban me vete përmes territorit të Republikës së Maqedonisë, nëse ai është i pajisur me licencë të vlefshme për armën, e lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit të tij ose me autorizim të lëshuar nga përfaqësia diplomatike përgjegjëse në territorin e Republikës së Maqedonisë në shtetin e huaj.”

Neni 32

Pas nenit 66 shtohet neni 66-a me këtë përmbajtje:

“Neni 66-a

Mbajtësit e pasaportave diplomatike ose pjesëtarët e një organizate ndërkombëtare, të cilët qëndrojnë ligjërisht në Republikën e Maqedonisë, mund të sjellin në territorin e

Republikës së Maqedonisë në bazë të autorizimit të lëshuar për hyrjen dhe mbajtjen e armës për gjueti ose sport, armët që posedojnë me licencë të vlefshme të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër, dhe që përdoren për gjueti apo sport.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga oficeri i policisë në pikën kufitare ku kalohet kufiri shtetëror.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është i vlefshëm gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit ligjor të personit që e fut armën në vend.

Arma për të cilën është lëshuar autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të dorëzohet nga mbajtësi në përputhje me dispozitat e neneve 28 deri 40 të këtij ligji.

Mbajtësi i armës për të cilën është lëshuar autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nuk është i detyruar ta nxjerrë armën jashtë kufirit të Republikës së Maqedonisë, në çdo dalje të tij jashtë shtetit, me përjashtim të rasteve kur largohet nga vendi duke qenë se nuk ekziston më një bazë për qëndrimin e tij/saj të ligjshëm në vend.

Neni 33

Në nenin 67 paragrafi 2 fjalët: “Organi përgjegjës që kontrollon pikën e kalimit të kufirit shtetëror” ndryshohet me fjalët: “Oficeri i policisë në pikën e kalimit kufitar ku kalohet kufiri shtetëror”.

Pas nenit 2 shtohen paragrafët 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“Shtetasit e huaj të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë me municion për armët me tytë të vjaskuar deri në 100 plumba, ose municion për armët me tytë të pavjaskuar deri në 500 plumba.

Sasia e municionit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni i referohet çdo hyrje të armëve në territorin e Republikës së Maqedonisë për qëllime gjuetie.”

Neni 34

Në nenin 72 paragrafi 1 fjalët “dokument evropian i lëshuar për armët” ndryshohen me fjalët: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Në paragrafin 4 fjalët: “dokument evropian për armët” ndryshohen me fjalët: “leje evropiane për armët e zjarrit”.

Në paragrafin 6 pas fjalëve: “nëse për armët” shtohen fjalët: “përmendur në nenin 4 paragrafi 4, 5 dhe 6 të këtij ligji”, ndërsa fjalët: “dokument evropian i lëshuar për armët” ndryshohet me fjalët: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Pas paragrafit 6 shtohen paragrafët 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“Armët e zjarrit që janë të ndaluara për blerje dhe posedim në Republikën e Maqedonisë në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3 të këtij ligji nuk mund të hyjnë në Republikën e Maqedonisë nga shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni.

Gjatë udhëtimit me leje evropiane për armët e zjarrit, mbajtësi i armës së zjarrit nuk paguan tarifa ose taksa gjatë kohës së shfrytëzimit të lejes në vend.”

Neni 35

Në nenin 73 paragrafi 1 fjalët: “dokument evropian i lëshuar për armët” zëvendësohen me: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Në paragrafin 2 fjalët: “dokument evropian i lëshuar për armët” zëvendësohen me fjalët: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Në paragrafin 3 fjalët: “dokument evropian i lëshuar për armët” zëvendësohen me fjalët: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Neni 36

Pas nenit 73 shtohet neni 73-a me këtë përmbajtje:

“Neni 73-a

Lejen evropiane për armët e zjarrit për shtetasit e Republikës së Maqedonisë e lëshon organi përgjegjës.

Në lejen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni plotësohen të gjitha ndryshimet dhe karakteristikat e armës së zjarrit, si dhe humbja ose vjedhja e armës së zjarrit.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ka afat vlefshmërie deri në pesë vjet, vlefshmëri e cila mund të zgjatet edhe për pesë vite.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban seksione ku plotësohen:

- të dhënat personale për poseduesin e armës,
- të dhënat për armën, dhe veçanërisht kategoria e armës së zjarrit,
- afati i vlefshmërisë së lejes evropiane për armët e zjarrit,
- shënimet për armët e zjarrit (organi përgjegjës që ka lëshuar lejen),
- shënimet nga shtete të tjera në lidhje me dokumentet e nevojshme për hyrjen e armës në territorin e tyre (autorizim për hyrje, etj),
- deklarata që gjatë kohës së udhëtimit në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian me një ose më shumë armë të kategorive B, C dhe D janë të nevojshme dokumentet përkatëse për armët të lëshuara nga organi përgjegjës në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian dhe
- deklarata se ndalohet blerja dhe posedimi i armëve të zjarrit pjesë e kategorive B, C dhe D ose nevojitet miratim për blerjen dhe posedimin e tyre.”

Neni 37

Në nenin 74 fjalët: “dokument evropian i lëshuar për armët” zëvendësohen me fjalët: “leje evropiane e lëshuar për armët e zjarrit”.

Neni 38

Në nenin 77 paragrafi 3 fjala “pesë” ndryshohet me fjalët: “të paktën 20”.

Neni 39

Në nenin 78 paragrafi 5 fjala “gjykata” zëvendësohet me fjalët: “Regjistri Qendror i Republikë së Maqedonisë”.

Neni 40

Në nenin 80 paragrafi 1 pika 13 lidhësja “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 14 pika zëvendësohet me lidhësen “dhe”, dhe pas kësaj pike shtohet pika 15 me këtë përmbajtje:

“15) nuk do të nxjerrë armën jashtë kufirit të Republikës së Maqedonisë, në largimin e tij të parë nga territori i vendit (neni 62 paragrafi 3).“

Neni 41

Në nenin 81 paragrafi 1 pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2) nuk do t’i shesë blerësit të armës tre copë municione të përshtatshme për llojin e armës;”.

Pika 4 numërohet 5 dhe pas saj shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6) nuk e raporton armën e blerë për qitje eksperimentale brenda periudhës së parashikuar, d.m.th. nuk dorëzon një kërkesë për regjistrimin e armës brenda periudhës së parashikuar (neni 35, paragrafët 3 dhe 4);

7) nuk e raporton armën e shkëmbyer brenda periudhës së parashikuar, d.m.th. nuk paraqet një kërkesë për regjistrimin e armës brenda periudhës së parashikuar (neni 35,

paragrafët 3 dhe 4);

Pikat 5, 6 dhe 7 numërtohen përkatësisht 8, 9 dhe 10.

Pas pikës 8 e cila numërtohet 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12) nuk regjistron për kryerjen e qitjeve eksperimentale brenda periudhës së parashikuar një armë pjesët e së cilës janë riparuar, d.m.th. nuk paraqet një kërkesë për regjistrimin e pjesëve të riparuar të armës së zjarrit (neni 49, paragrafi 3);”

Pas pikës 9 e cila numërtohet 13 shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:

“14) qitja në poligonin civil në mungesë të një përfaqësuesi të subjektit juridik (neni 59 paragrafi 4);”

Pikat 10 dhe 11 numërtohen përkatësisht 15 dhe 16.

Pika 12 e cila numërtohet 17 ndryshohet si më poshtë:

“17) nuk regjistron armën që ai/a jo synon të fusë në Republikën e Maqedonisë (neni 64 paragrafi 1);”

Pas pikës 17 shtohen pikat 18 dhe 19 me këtë përmbajtje:

“18) nuk paraqet asnjë kërkesë për zëvendësimin e autorizimit për armën të lëshuar nga autoriteti përgjegjës i një shteti tjetër dhe nuk e dorëzon armën për të kryer qitjet eksperimentale brenda periudhës së parashikuar (neni 64 paragrafi 3);

19) ai/a jo nuk e nxjerr armën jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë brenda periudhës së parashikuar (neni 64, paragrafi 5);”

Pikat 13 dhe 14 numërtohen përkatësisht 20 dhe 21.

Neni 42

Në nenin 82 paragrafi 1 pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“7) nuk mban një regjistër për të monitoruar prodhimin, riparimin, tregtimin dhe transportin e armëve brenda periudhës së parashikuar (neni 48-a paragrafi 4);

8) nuk e hedh informacionin në regjistër për monitorimin e prodhimit, tregtimit, riparimit dhe transportit të armëve (neni 48-a paragrafi 5);

9) brenda periudhës së parashikuar, nuk paraqet raportet për qitjet eksperimentale të armëve të zjarrit pjesët kryesore të të cilave janë riparuar (neni 49 paragrafi 3);”

Pikat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 numërtohen përkatësisht 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Në paragrafin 2 fjalët: “pikat 4 deri në 12” zëvendësohen me fjalët: “pikat 4, 5, 6, 10, 11, 12, 13, 14, 15”.

Në paragrafin 3 fjalët: “pikat 1, 2, 3, 5, 7, 8 dhe 12” ndryshohen me fjalët: “pikat 1, 2, 3, 5, 10, 11 dhe 15”.

Në paragrafin 4 fjalët: “pikat 4 deri në 13” ndryshohen me fjalët: “pikat 4, 5, 6, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16”.

Neni 43

Në nenin 83 paragrafi 1 pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“7) nuk e raporton armën e blerë për kryerjen e qitjeve eksperimentale brenda periudhës së parashikuar, d.m.th. nuk paraqet kërkesën për regjistrimin e armës brenda periudhës së parashikuar (neni 35 paragrafët 3 dhe 4);

8) nuk raporton armën e shkëmbyer, d.m.th. nuk e raporton armën e shkëmbyer për kryerjen e qitjeve provë (neni 35-a paragrafi 4);”

Pika 7 numërtohet “9”.

Pas pikës 8 e cila numërtohet 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11) brenda periudhës së parashikuar, nuk krijon lidhje elektronike me regjistrin elektronik për ndjekjen e procesit të prodhimit, riparimit, tregtimit dhe transportimit të armëve dhe nuk hedh të dhënat e parashikuara në regjistër (neni 48-a paragrafi 2 dhe 3);”

Pika 9 e cila numërtohet 12 ndryshohet si më poshtë:

“12) nuk paraqet një raport për riparimin e pjesëve kryesore të armës së zjarrit brenda periudhës së parashikuar (neni 49 paragrafi 4);”.

Pas pikës 12 shtohen pikat 13 dhe 14 me këtë përmbajtje:

“13) nuk ndërmerr masat e duhura për kapërcimin e dëmeve nga qitjet joprofesionale në poligonin e qitjes (neni 59 paragrafi 5);

14) nuk njofton, brenda periudhës së parashikuar, organin përgjegjës për transportin e kryer të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre (neni 56 paragrafi 7 dhe neni 56-a paragrafi b) dhe”.

Pika 10 numërtohet 15.

Neni 44

Në nenin 83-a paragrafi 1 dhe 83-b paragrafi 1 fjalët: “nenet 86 dhe 86-b” ndryshohen me fjalët: “nenet 86, 86-b dhe 86-d”.

Neni 45

Pas nenit 86-c shtohet neni 86-d me këtë përmbajtje:

“Neni 86-d

Pronari i armës i përmendur në nenin 4 paragrafi 5 pika 7, 8 dhe 9 të këtij ligji është i detyruar të zëvendësojë autorizimin e armës me licencë për armën, ose licencë për mbajtjen e armës brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zëvendësimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni kryhet me dorëzimin personalisht të kërkesës për zëvendësimin e autorizimit me licencë për përdorim arme, ose licencë për posedim arme.”

Neni 46

Në nenin 88 fjalët: “kapitulli X nga” ndryshohen me fjalët: “neni 73-a nga”.

Neni 47

Shoqëritë tregtare të përmendura në nenin 48-a paragrafi 2 të këtij ligji do t'i harmonizojnë veprimtaritë e tyre brenda gjashtë muajve nga dita e fillimit të zbatimit të dispozitës së përcaktuar me nenin 48-a paragrafi 1 të këtij ligji.

Shoqëritë tregtare të përmendura në nenin 48-a paragrafi 2 të këtij ligji, regjistrin për ndjekjen e procesit të prodhimit, riparimit, tregtimit dhe transportimit të armëve do të fillojnë ta mbajnë brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me nenin 48-a paragrafi 8 të këtij ligji.

Neni 48

Aktet nënligjore të nenit 48-a paragrafi 8 të këtij ligji do të miratohen brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 49

Autorizohet Komisioni për Çështjet Ligjore i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë konsolidimin e tekstit të ligjit “Për armët”.

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë pas shpalljes në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, përveç dispozitës së nenit 20 të këtij ligji me të cilën shtohet dispozita e nenit 48-a paragrafi 1 e cila do të fillojë të zbatohet dy vjet pas ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.